



AKT -THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE “PANORAMA GROUP” SH. A. TIRANE

Neni 1

Në bazë të ligjit Nr 7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private dhe të privatizimit” dhe ligjit Nr 7667 dt 28.07.1993 “Për regjistrimin e shoqërive në Regjistrin Tregtar” me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti Themeluesit:

1. **Irfan HYSENBELLIU** lindur më 08.04.1959, në Skrapar dhe banues në Rr.”Pjeter Bogdani, P.11, Ap 7 Tirane, nr.pasaporte 1762730
2. **Alban XHAFERRI** lindur më 07.04.1970 në Durrës dhe banues në Tirane, nr.pasaporte 0868551.
3. **Lefter SOTA** lindur më 19.09.1956 në Vlorë dhe banues në Vlorë, nr.pasaporte Z0114043

Deklarojnë se kanë nënshkruar këtë kontratë dhe kanë rënë dakort për krijimin e një shoqërie anonime pa ofertë publike në bazë të këtij akti themelimi si dhe statutit duke respektuar edhe kërkesat e legjislationit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 2

Emërtimi dhe forma e shoqërisë

Emri i Shoqërisë Tregtare do të jetë “**PANORAMA GROUP**” Sh.a. Forma e shoqërisë do të jetë shoqëri anonime pa ofertë publike dhe në vazhdim do të referohet si shoqëri anonime.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

- Veprimtari të medias së shkruar të të gjitha llojeve.
- Veprimtari të medias elektronike lokale.
- Krijimi i Gazetës së re, të pavarur, kombëtare “**PANORAMA**”.
- Krijimin e revistës së re të pavarur, kombëtare “**PANORAMA**”.
- Krijimine stacionit televiziv lokal “**PANORAMA**”.
- Veprimtari në fushën e shtypshkrimeve e publikimeve, medias elektronike të të gjitha llojeve.
- Veprimtari në fushën e turizmit, të klubeve, shërbimeve të udhëtimit të të gjitha llojeve.



Veprimtari në fushën e ndertimit.

Veprimtari në fushën e prodhimit.

Import-eksport dhe shitje artikujsh dhe mallrash të ndryshëm, lëndët e para industriale, makineri, pajisje, të licënuara nga organe të tjera kompetente në rastet kur kërkohet.

- Agjensi shërbimesh të ndryshme.
- Konsulencë ekonomike, financiare, tregtare, legale, fiskale, bankare për persona fizikë e juridikë vendas dhe të huaj.
- Operacione të ndryshme tregtare, industriale, financiare, të pasurive të tundshme ose të patundshme, të konsideruara të nevojshme për realizimin e aktivitetit të saj.
- Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo shoqëri brenda ose jashtë vendit.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë është caktuar në adresën Rr."Gjin Bue Shpata", pranë stadiumit "Dinamo". Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të këshillit mbikqyrës të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar 30 vjet, duke filluar nga data e regjistruar në regjistrin tregtar në gjykatën e Tiranës. Shkurtimi ose zgjatja e këtij afati bëhet me vendim të asamblesë së aksionerëve.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 000 lekë.

Ky kapital ndahet në 1 000 aksione me vlerë nominale 10 000 lekë secili. Këto aksione janë kontribut në para dhe janë nënshkruar tërësisht nga aksionerët si vijon:

Nr	Emri Mbiemri	Nr.i aksioneve	Aksione të zotëruar	Vlera nominale	Kontributi në lekë	% në shoqëri
1	Irfan HYSENBELLIU		340		3 400 000	34%
2	Alban XHAFERRI		330		3 300 000	33%
3	Lefter SOTA		330		3 300 000	33%

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vletës nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë, me kompesim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyruar për t'u shlyer nga shoqëria, në përfshirje të rezervave, fitimeve, primeve të emetimit, kontribut në natyrë, ose me shndërrimin e obligacioneve. Në rast se zmadhimi i



kapitalit bëhet me kontribut në natyrë, me vendim të gjykatës përkatëse emerohen 1 ose më shumë eksperte që do të vlerësojnë vlerën e këtij kontributi në bazë të nenit 162 dhe kushtimit të neneve 168,169 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Aksioneri ka të drejtë përparësie në nënshkrimin e aksioneve të reja për rritjen e kapitalit me para në dorë propocionalisht me shumat e aksioneve që zotëron, çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme. Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të analizohet konform nenit 153 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksionerëve bëhet vetëm me pëlqim unanim të aksionerëve, me përjashtim të rastit kur ai realizonhet me përfshirjen e rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit.

Neni 7

Nënshkrimi i kapitalit dhe shlyerja e aksioneve

Në momentin e themelimit janë sjellë si kontribut më para nga aksionetët e shoqërisë një shumë prej 10 000 000 lekë e cila vërtetohet nga çertifikata e depozitimit të fondeve dhe lista e nënshkryesve si vijon:

- Irfan HYSENBELLIU 3 400 000 lekë
- Alban XHAFERRI 3 300 000 lekë
- Lefter SOTA 3 300 000 leke

Neni 8

Evidentimi i derdhjeve të kryera

Derdhjet e kryera evidentohen nga një çertifikatë e mbajtjesit të fondeve e hartuar në momentin e depozitimit të fondeve, mbi bazën e listës së aksionerëve ku janë shënuar shumat e derdhura nga secili prej tyre.

Neni 9

Depozitimi i fondeve dhe i listës së nënshkryesve

Fondet si dhe lista e nënshkryesve dhe shumat e derdhura nga secili depozitohen tek një noter, ose në bankë për llogari të shoqërisë në formim e sipër. Derdhjet evidentohen me një çertifikatë të mbajtësit të fondeve, mbi bazën e listës së aksioneve ku janë shënuar shumat e derdhura nga secili prej tyre.

Neni 10

Fitimi që do shpërmdahet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit ose statutit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Shpërndarja e fitimit që do të rezultojë nga bilanci ekonomik -financiar për çdo vit ushtrimor për aksionerët do të bëhet në raportet që vijnë:

Emri mbiemri	Perqindja e fitimit/humbjes
1. Irfan HYSENBELLIU	34%
2. Alban XHAFERRI	33%
3. Lefter SOTA	33%

Neni 11
Firmosja e statutit.

Statuti firmoset nga aksionerët ose nga autorizuesit e ngarkuar prej tyre pasi të hartohet çertifikata e mbajtësit të fondeve.

Neni 12
Caktimi i drejtuesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar.

Anëtarët e parë të këshilit mbikqyrës dhe ekspertët e parë kontabël caktohen në satut.

Neni 13
Prishja e shoqërisë.

Prishja e shoqërisë shpallet në mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme. Shoqëria priset automatikisht me mbarimin e aftit sipas statutit.

Shoqëria mund të mbyllë aktivitetin e saj përpara afatit të caktuar në kontratë, kur:

- Aksionerët vendosin me marrëveshje për mbylljen
- Aktiviteti rezulton me humbje për një periudhë prej tre vjetësh të njëpasnjëshëm.
- Kur kapitalet e veta bëhen më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar.

Në rast të mbylljes së aktivitetit, në çdo kohë ose për çdo arsye Asambleja e përgjithshme e aksionerëve cakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar fuqitë dhe kompetencat. Likuidimi i shoqërisë bëhet në bazë të dispozitave që përcaktohen nga ligji.

Neni 14
Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje ndërmjet aksionerëve, e lindur në kuadrin ose për shkak të këtij statuti, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet Gjykatës së Tiranës, duke u gjykuar mbi bazën e ligjeve shqiptare

Neni 15
Dispozita të fundit

Të gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin ekonomik të shoqërisë.

Pjesa e pandarë e aktit të themelimit është sattuti i cili do të nënshkruhet njëherazinga themeluesit e shoqërisë pasi të hartohet çertifikata e mbajtësit të fondeve.



Ky Akt-Themelimi u shkrua, u lexua dhe u firmos me vullnet të lirë e ndërgjegje plotë nga aksionerët para noterit në Tiranë, sot më datë 02.09.2002 në katër kopje në gjuhën shqipe.

Skënder Hysenbelliu Alban Xhaxhiu
[Signature] *[Signature]* Lefter Pota
[Signature] *[Signature]* *[Signature]*



**-STATUTI-
I SHOQERISE TREGTARE
"PANORAMA GROUP" SH.A. TIRANE**

Aksionerët e mëposhtëm kanë themeluar shoqërinë anonime : **"PANORAMA GROUP"**
Sh.a.konform aktit të themelimit të kësaj shoqërie.

1-Irfan HYSENBELLIU
2-Alban XHAFERRI
3-Lefter SOTA

Deklarojmë se kanë hartuar si më poshtë vijon statutin e shoqërisë anonime pa ofertë publike të emëruar: "PANORAMA GROUP" Sh.a. të themeluar midis tyre. Sh.a. fiton personalitet juridik nga data e themelimit të saj në gjykatën e rrethit Tiranë. Ajo është person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe ato të akteve të saj themeluese "Statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë"

KREU I

Objekti i veprimtarisë – Selia e shoqërisë – Kohëzgjatja

Neni 1

Aktivitetin e saj, shoqëria do ta zhvillojë në bazë të këtij statuti dhe neneve 74-78, 89-93, 96-210, të ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

- Veprimtari të medias së shkruar të të gjitha llojeve.
- Veprimtari të medias elektronike lokale.
- Krijimi i Gazetës së re, të pavarur, kombëtare **"PANORAMA"**.
- Krijimin e revistës së re të pavarur, kombëtare **"PANORAMA"**
- Krijimine stacionit televiziv lokal **"PANORAMA"**
- Veprimtari në fushën e shtypshkrimeve e publikimeve, medias elektronike të të gjitha llojeve.
- Veprimtari në fushën e turizmit, të klubeve, shërbimeve të udhëtimeve të të gjitha llojeve
- Import-eksport dhe shitje artikujsh dhe mallrash të ndryshëm, lëndët e para industriale, makineri, pajisje, të licensuara nga organe të tjera kompetente në rastet kur kërkohet.
- Agjensi shërbimesh të ndryshme
- Konsulencë ekonomike, financiare, tregtare, legale, fiskale, bankare për persona fizikë e juridikë vendas dhe të huaj.



Operacione të ndryshme tregtare, industriale, financiare, të pasurive të tundshme ose të patundshme, të konsideruara të nevojshme për realizimin e aktivitetit të saj. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo shoqëri brenda ose jashtë vendit.

Neni 3

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë është caktuar në adresën Rr."Gjin Bue Shpata", pranë stadiumit "Dinamo". Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një vendimi të këshillit mbikqyrës të saj.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar 30 vjet, duke filluar nga data e regjistruar në regjistrin tregtar në gjykatën e Tiranës. Shkurtimi ose zgjatja e këtij afati bëhet me vendim të asamblesë së aksionerëve.

KREU II

Neni 5

Kapitali themeltar – Aksionet

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 000 lekë.

Ky kapital ndahet në 1 000 aksione me vlerë nominale 10 000 lekë secili. Këto aksione janë kontribut në para dhe janë nënshkruar tërësisht nga aksionerët si vijon:

Nr	Emri Mbiemri	Nr i aksioneve	Aksione të zotëruar	Vlera nominale	Kontributi në lekë	% në shoqëri
1	Irfan HYSENBELLIU		340		3 400 000	34%
2	Alban XHAFERRI		330		3 300 000	33%
3	Lefter SOTA		330		3 300 000	33%
4						

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë duhet nënshkruar plotësisht. Në momentin e nënshkrimit të paktën $\frac{1}{2}$ e vlerës nominale të aksioneve për kontributin në para duhet të jetë shlyer. Aksionet për kontributin në natyrë shlyhen plotësisht që në momentin e nënshkrimit. Aksionet nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime. Shlyerja e vlerës së mbetur në aksione do të bëhet me këste brenda periudhës një mujore nga data e firmosjes së statutit të kësaj shoqërie.

Kur aksioneri nuk ka shlyer shumat që mbeten për tu derdhur mbi vlerën e aksioneve të nënshkruar prej tij në afatet e fiksuara në këtë statut, shoqëria i drejton atij një

paralajmërim. N.q.s aksioneri nuk i përgjigjet për një muaj paralajmërimin të drejtorisë shoqëria bën shitjen e këtyre aksioneve pa paralajmërim gjyqësor. Aksioneri që ka nënshkruar aksionet e shoqërisë është në parim debitor ndaj saj për shumat që duhet të shlyejë nga data e caktuar për shlyerje. Kështu që më rastë të mosshlyerjes së detyrimit ai mund t'u nënshtrohet programit të interesave për vonesë "kamata" sipas tarifës ligjore si dhe të paguajë një dëmshpërblim financiar n.q.s. provohet që mosshlyerja i ka sjellë dëm shoqërisë. Në vijim shoqëria do të zbatojë nenet 208,209,210 të ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Neni 7

Depozitimi i fondeve dhe listës së nënshkruesve.

Fondet si dhe lista e nënshkruesve dhe shumat e derdhura nga secili depozitohen tek një noter, ose në bankë për llogari të shoqërisë në formim e sipër. Derdhjet evidentohen me një çertifikatë të mbajtësit të fondeve, mbi bazën e listës së aksioneve ku janë shënuar shumat e derdhura nga secili prej tyre.

Neni 8

Kontributi në para në kapital.


Në momentin e themelimit janë sjellë si kontribut më para nga aksionetë e shoqërisë një shumë prej 10 000 000 lekë e cila vërtetohet nga çertifikata e depozitimit të fondeve dhe lista e nënshkruesve si vijon:

- | | |
|---------------------|----------------|
| ➤ Irfan HYSENBELLIU | 3 400 000 leke |
| ➤ Alban XHAFERRI | 3 300 000 leke |
| ➤ Lefter SOTA | 3 300 000 leke |

Neni 9

Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vletës nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë, me kompesim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyruar për t'u shlyer nga shoqëria, në përfshirje të rezervave, fitimeve, primeve të emetimit, kontribut në natyrë, ose me shndërrimin e obligacioneve. Në rast se zmadhimi i kapitalit bëhet me kontribut në natyrë, me vendim të gjykatës përkatëse emetohetbl ose më shumë ekspert që do të vlerësojnë vlerën e këtij kontributi në bazë të nenit 162 dhe kufizimit të neneve 168,169 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Aksioneri ka të drejtë përparësie në nënshkrimin e aksioneve të reja për rritjen e kapitalit me para në dorë propocionalisht me shumat e aksioneve që zotëron, çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme. Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet të analizohet konform nenit 153 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksionerëve bëhet vetëm me pëlqim unanim të aksionerëve, me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshirjen e rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit.



Neni 10
Shlyerja dhe verifikimi i kapitalit.

Nuk mund të merret vendim dhe të realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para në dorë nëse kapitali aksionar i deritanishëm nuk është shlyer plotësisht. Në rast të kundërt operacioni i zmadhimit të kapitalit dhe i emetimit të aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm në bazë të nenit 154 të ligjit 7638/92. Këshilli mbikqyrës në çdo rast të zmadhimit të kapitalit duhet që në një afat 3 mujor nga realizimi i zmadhimit të kapitalit të verifikojë depozitimimin e kapitalit. Nëse kapitali nuk është mbuluar plotësisht atëherë këshilli mbikqyrës disponon lirshëm aksionet e pambuluara tek të tretët ose kapitali aksionar shtohet deri në shumën e mbulimit të tij.

Neni 11
Zvogëlimi i kapitalit

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga asambleja e jashtëzakonshme në mbledhjen e saj e cila mund t'i japë drejtorisë të gjitha kompetencat për ta realizuar. Në asamblenë e përgjithshme që thirret për zvogëlimin e kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i drejtorit, duke shpjeguar arsyet që e bëjnë të detyrueshme marrjen e vendimit përkatës.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë, në bazë të nenit 164 të ligjit 7638/92. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme që thirret për të vendosur mbi këtë projek

KREU III

AKSIONET

Neni 12

Aksionet paraqiten në formën e aksioneve nominative dhe janë të formës emërore. Aksioni për kontributin në para është nominativ deri në shlyerjen e tij të plotë.

Neni 13

Aksionet janë të tregtueshme vetëm pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar ose në rastin e një rritjeje kapitali, pas regjistrimit të këtij ndryshimi. Aksionet mbeten të tregtueshme pas prishjes së shoqërisë deri në përfundimin e likudim.

Neni 14

Me përjashtim të rasteve të trashëgimisë, transferimi i pronësisë mbi aksionet e një personi të tretë pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të nënshtrohet

pëlqimit të shoqërisë. Ndryshimi i pronësisë së aksioneve si rrjedhojë e një shitjeje ose transferimi bëhet në bazë të urdhërkalimit në regjistër.

Neni 15

Transferimi i pronësisë mbi aksionet e një personi joaksioner, kur nuk realizohet tregtimi, në mungesë të marrveshjes ndërmjet palëve çmimi i aksioneve përcaktohet sipas dispozitave të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 16

Shoqërisë i dorëzohet një kërkesë miratimi ku tregohet emri, mbiemri dhe adresa e personit që transferohet pronësia, numri i aksioneve që parashikon transferimi i pronësisë dhe çmimi i ofruar. Miratimi konsiderohet i dhënë nëpërmjet një njoftimi ose kur nuk ka përgjigje brenda një afati 3-mujor nga data e kërkesës. N.q.s shoqëria nuk miraton personin e propozuar për transferimin e pronësisë drejtorja detyrohet që brenda 3 muajsh që nga data e njoftimit të refuzimit të blejë aksionet nëpërmjet një aksioneri ose personi të tretë pao me pëlqimin e personit që humb pronësinë nga vetë shoqëria, me qëllim të zvogëlimit të kapitalit.

Neni 17

Aksionet janë të pandashme kundrejt shoqërisë e cila njih vetëm një pronar kryesor të një aksioni. Çdo aksion jep të drjtën e një vote. Një aksion nuk mund të ketë më shumë se një zotërues. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm prurësi i tij i ligjshëm. Aksionerët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zotërojnë. Çdo kërkim fondesh përtej kësaj është i ndaluar.

Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e marrjes së një pjese nga fitimi i shoqërisë në përpjestim me kuotën pjesë të kapitalit që ai përfaqëson, si dhe i jep zotëruesit të tij të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në asamblenë e përgjithshme. Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre përsa i përket drejtorit të shoqërisë nëpërmjet asamblesë së përgjithshme të aksionerëve.

KREU IV

Neni 18

Organet e Shoqërisë

Shoqëria drejtohet organizohet dhe administrohet nga organet e saj që janë **KËSHILLI MBIKQYRËS DHE DREJTORIA**

KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 19

Kompetencat e këshillit mbikqyrës



Këshilli mbikqyrës ushtron kontroll të përhershëm dhe të vazhdueshëm ndaj drejtorit dhe anëtarëve të tjerë të drejtorisë për drejtim dhe administrimin e shoqërisë nga ana e saj. Këshilli mbikqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë të vitit veprimet për kontrollin që i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentat që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Këshilli mbikqyrës vendos për operacionet që do të kryhen më autorim të tij nga drejtoria.

Këshilli mbikqyrës miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, kriteret e punësimit dhe të pagave si dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

Drejtori i paraqet raport këshillit mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar drejtori i paraqet këshillit mbikqyrës dokumentat që përcaktohen në nenin 130 paragrafi 2 i këtij ligji me qëllim verifikimin dhe kontrollin. Këshilli mbikqyrës, në përputhje me nenin 130, i paraqet vërejtjet e tij mbi raportin e drejtorisë si dhe ato mbi llogaritë e vitit financiar.

Neni 20

Përberja e këshillit mbikqyrës

Këshilli mbikqyrës përbëhet nga 3 anëtar. Asnjë anëtar i këshillit mbikqyrës nuk mund të jetë drejtor i shoqërisë. Në rast se një anëtar i këshillit mbikqyrës emërohet drejtor atëherë mandati i tij në këshillin mbikqyrës përfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.

Neni 21

Emërimi i anëtarëve të Këshillit mbikqyrës, kohëzgjatja.

Dy të tretat e Anëtarëve të këshillit mbikqyrës emërohen me unanimitet nga mbledhja themeluese e asamblesë ose nga mbledhja e zakonshme e asamblesë bazuar në nenin 105 të këtij ligji.

Një e treta e Anëtarëve të këshillit mbikqyrës zgjidhet nga të punësuarit në Shoqëri, bazuar në nenin 110 të ligjit. Mandati i anëtarit të këshillit mbikqyrës i zgjedhur nga të punësuarit është i papajtueshëm me çdo mandat tjetër përfaqësues të të punësuarve të shoqërisë.

Anëtarët e këshillit mbikqyrës aksioner të emëruar nga asambleja e aksionerëve nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri, me përjashtim të rasteve sipas nenit 105 të ligjit kur anëtarët e këshillit mbikqyrës zgjidhen nga të punësuarit.

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të këshillit mbikqyrës është 3 vjet. Anëtarët mund të rizgjidhen dhe mbas këtij afati. Ata mund të shkarkohen në çdo moment nga asambleja e zakonshme. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me rregullat e mësipërme është i pavlefshëm me përjashtim të rasteve kur veprohet në kushtet e parashikuara nga neni 108 i ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Një person juridik mund të emërohet në këshillin mbikqyrës. Ai duhet të caktojë një përfaqësues të përhershëm që u nënshtrohet po atyre kushteve dhe detyrimeve dhe ka të njëjtat përgjegjësi civile e penale sikur të ishte vetë ai antarë i këshillit, duke mos përjashtuar nga përgjegjësia e përbashkët personin juridik që ai përfaqëson. Personi juridik që shkarkon përfaqësuesin e tij duhet të paraqesë njëkohësisht zëvendësuesin.

Anëtarët e këshillit mbikqyrës me vendim të Asamblesë mund të caktojë një shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje në një shumë vjetore fikse, kjo përballohet nga flogaria e shoqërisë dhe kalon në shpenzim të saj.

Neni 22

Kryetari dhe zv/kryetari i këshillit mbikqyrës.

Këshilli mbikqyrës zgjedh nga gjiri i tij një kryetar dhe një zëvendës kryetar që i ngarkon me mbledhjen e këshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij. Kryetari është person fizik dhe nuk mund të zgjidhet nëpërmjet përfaqësuesve të personave juridik.

Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë gjithë periudhës së mandatit të këshillit mbikqyrës. Kryetar i këshillit mbikqyrës do të jetë : Lefter SOTA.
Këshilli mbikqyrës i emëruar do të drejtojë shoqërinë rezulton si vijon:

Nr	Anetaret	Juridsioni	Përfaqësues	Funksioni
1.	Lefter SOTA			Kryetar
2.	Alban XHAFERRI			Zv/kryetar
3.	Artan HAJDARI			Anetar

DREJTORIA

Neni 23

Emërimi i drejtorisë

Shoqëria "PANORAMA GROUP" sh.a. drejtohet nga Drejtoria. Drejtoria e ushtron funksionin e saj nën kontrollin e një këshilli mbikqyrës.

Emërimi i drejtorit bëhet nga këshilli mbikqyrës.


Drejtori është person fizik në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Këshilli mbikqyrës mund të zgjedhë drejtorin dhe anëtarët e drejtorisë edhe jashtë bashkësisë së aksionerëve. Drejtoria e shoqërisë përbëhet nga dy anëtare.

Drejtor i shoqërisë Zef NDREKA.

Neni 24

Shkarkimi i Drejtorit dhe anetareve të Drejtorisë

Drejtori dhe anetarët e drejtorisë mund të shkarkohen për shkaqe të perligjura nga këshilli mbikqyrës sipas nenit 98 të ligjit 7638/92. Si shkaqe të perligjura konsiderohen veçanërisht fajet e rënda të Drejtorit dhe anetareve të drejtorisë, si paaftësia e tyre në kryerjen korrekte të funksioneve, kur asambleja humbet besimin tek kjo drejtori, si dhe kur demtohen interesat e shoqërisë. Përfshihen rastet kur shkarkimi është i nxituar haptazi nga shkaqe që kanë të bëjnë me interesat e shoqërisë. Shkarkimi mbetet në fuqi deri sa vendimi gjyqësor që e vërteton pavlefshmërinë e shkarkimit për të marrë fuqi ligjore.





Neni 25

Kohëzgjatja e mandatit të drejtorit dhe anëtarëve të drejtorisë.

Kohëzgjatja e mandatit të drejtorit dhe anëtarëve të drejtorisë caktohet 4 vjet. Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme ka të drejtë të ndryshojë kohëzgjatjen e mandatit të drejtorisë së caktuar me statut, ta zgjasë ose ta shkurtojë atë. Kur një ose më shumë vende në drejtori mbeten bosh, këshilli mbikqyrës emëron zëvendësues deri në mbarimin e mandatit të drejtorisë.

Neni 26

Shpërblimi i anëtarëve të drejtorisë.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të secilit anëtar të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikqyrës më aktin e emërimit.

Neni 27

Kompetencat e drejtorisë dhe marja e vendimeve nga ana e saj.

Drejtorja ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo i ushtron këto kompetenca brenda objektit të shoqërisë, vendimet drejtorja i merr me shumicë votash. Ajo kufizohet nga ato kompetenca që ligji u jep shprehimisht këshillit mbikqyrës. Shoqëria në marrëdhënie me të tretët merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e Drejtorisë edhe kur keto akte nuk përfshihen në objektin e drejtorisë. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Drejtorisë e kalon objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është prove e mjaftueshme. Me autorizim të këshillit mbikqyrës anëtarët e drejtorisë ndajne midis tyre detyrat për drejtimin e shoqërisë.

Drejtorja kërkon autorizim paraprak të këshillit mbikqyrës për veprimet e mëposhtme:

- Dhënia e dorzancisë dhe garancive
- Kryerja e investimeve tej atyre të parashikuara në programin financiar vjetor.
- Hapja e veprimtarisë ose degëve të reja, shkrirja, bashkimi dhe mbyllja tërësisht ose pjesërisht e veprimtarisë dhe degëve të shoqërisë.
- Pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara ose për tu krijuar.
- Shitja dhe shkëmbimi i pasurive që përbëjnë aktive të qëndrueshme të shoqërisë.
- Negocimi, përfundimi e ndryshimi i çdo kontrate me afat të gjatë ose për një shumë mbi kufijtë e caktuar çdo vit nga këshilli mbikqyrës.

Neni 28

Përfaqësimi tek të tretët.

Shoqëria përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga drejtori i saj. Ankesat apo kërkesat që të tretët i adresojnë shoqërisë janë të vlefshme kur ato dërgohen tek drejtori. Drejtori ka të drejtë të ngarkojë me kompetencën e përfaqësimit një anëtar tjetër të drejtorisë për

statutit që kufizojnë kompetencat e përfaqësimit të shoqërisë duhet të respektohen nga të
tretët

KREU V **ASAMBLEJA E AKSIONERËVE**

Neni 29

Asambleja është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje. Vetëm asambleja e Aksionerëve ka të drejtë e çdo ndryshimi të statutit. Asambleja e jashtëzakonshme merr vendim në përputhje me nenin 128 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 30

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që referohen në nenin 128 të ligjit 7638/92.

Asambleja e zakonshme merr vendim në përputhje me nenin 129,130 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” në mënyrë vendimore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shoqëritë tregtare.

Asambleja e zakonshme mbledhet një herë në vit ose brenda 6-mujorit mbas mbarimit të vitit financiar.

Asambleja shqyrton dhe vendos për të gjitha

Sëstjet e vitit financiar që mbyll. Ajo ushtron kompetencat që ka në bazë të neneve 105,108,109,123, paragrafi 3 dhe të nenit 125 të ligjit 7638/92.

Neni 31

Mbledhja e asmblesë së përgjithshme thirret nga këshilli mbikqyrës ose drejtoria. Në mungesë të tyre thirret:

- Nga eksperti kontabël.
- Nga personi i autorizuar nga gjykata sipas kërkesës së të interesuarit për një rast urgjent ose të një ose disa aksionerëve që zotërojnë 1/10 e kapitalit.
- Nga likuidatori.

Mbledhja e asmblesë së përgjithshme realizohet ashtu siç përcaktohet nga ligji.

Neni 32

Çdo aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga e shoqja, i shoqi.

Aksionerët e këshillit mbikqyrës dhe të drejtorisë kur janë aksioner marrin pjesë me votë vendimtare.

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 143 të ligjit 7638/92.

Neni 33

Eksperti Kontabël i Autorizuar.



Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar i cili emërohet për 1 vit financiar. Detyrat e ekspertit kontabël do të realizohen në përputhje me nenin 178,179,180, të ligjit 7638/92. Funksionet e tij përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë së zakonshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlerësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse sipas nenit 184 të ligjit.

Neni 34

Ekspert kontabël i autorizuar i shoqërisë emërohet Z.Kristaq NDINI.

KREU VI KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 35

Asambleja e përgjithshme do të emërojë një kontroll i cili ka licensën e kontabilit të miratuar dhe e ngarkon me këto detyra:

- Mbajtjen e llogarive të shoqërisë në mënyrë që ato të jenë sipas parimeve bazë të kontabilitetit.
- Përgatit raportin vjetor të të dhënave ekonomike dhe shpreh mendimin nëse të dhënat ekonomiko-financiare reflektojnë realitetin e gjendjes ekonomiko-financiare të shoqërisë.
- Informon këshillin mbikqyrës në lidhje me ndonjë parregullsi që vihet re në shëbimet, procedurat, aktivet ose llogaritë e shoqërisë të cilat do të mund të çonin në ekzistencën e humbjeve për shoqërinë.

Neni 36

Kontrolluesit e autorizuar kanë për detyrë të mbikqyrin llogaritë vjetore të cilat duhet të jenë të përpiluara në bazë të ligjit për kontabilitetin dhe të shprehin me saktësi rezultatet e periudhës ushtrimore si dhe të japin me sinqeritet rezultatit e dalë në fund të vitit financiar. Kontrolli i brendshëm ka dhe kompetenca që përcaktohen nga nenet 178,179,180,181 të ligjit 7638/92.

Neni 37

Në fund të çdo viti financiar këshilli mbikqyrës bën regjistrimin (inventarin) dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi për kontabilitetin, si dhe përpilon raportin për administrimin.



KREU VII

REZERVAT E DOMOSDOSHME, NDARJA E FITIMEVE DHE DIVIDENTET

Neni 38

Kapitali rezeveë kryhet në masën 5% të fitimit neto pasi më përpara të jenë zbitur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

Neni 39

Shpërndarja e fitimave.

Fitimi që do shpërndahet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbitur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit ose statutit dhe nga ana tjetër janë zbitur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Shpërndarja e fitimit që do të rezultojë nga bilanci ekonomik –financiar për çdo vit ushtrimor për aksionerët do të bëhet në raportet që vijnë:

Emri mbiemri	Perqindja e fitimit/humbjes
1.Irfan HYSENBELLIU	34%
2.Alban XHAFERRI	33%
3.Lefter SOTA	33%

Neni 40

Mbas miratimit të bilancit vjetor dhe regjistrimin e shumës që do të ndahet, Asambleja e përgjithshme cakton shumën që do të ndahet tek aksionerët në formën e dividendëve në bazë të neneve 215, 216 të ligjit 7638/92 (në bazë të kapitalit aksionar).

KREU VIII

PRISHJA E SHOQERISE

Neni 41

Prishja e shoqërisë shpallet në mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme. Shoqëria priset automatikisht me mbarimin e afitit sipas statutit. Shoqëria mund të mbyllë aktivitetin e saj përpara afatit të caktuar në kontratë, kur:

- Aksionerët vendosin me marrëveshje për mbylljen
- Aktiviteti rezulton me humbje për një periudhë prej tre vjetësh të njëpasnjëshëm.
- Kur kapitalet e veta bëhen më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar.



Në rast të mospjes së aktivitetit, në çdo kohë ose për çdo arsye Asambleja e përgjithshme e aksionerëve cakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar fuqitë dhe kompetencat. Likuidimi i shoqërisë bëhet në bazë të dispozitave që përcaktohen nga ligji.

Neni 42
Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje ndërmjet aksionerëve, e lindur në kuadrin ose për shkak të këtij statuti, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet gjykatës së Tiranës, duke u gjykuar mbi bazën e ligjeve shqiptare.

Neni 43
Dispozita e fundit

Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut dhe gjatë themelimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat në fuqi të ligjit Nr 7638 dt 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" kreu i peste "Për shoqëritë anonime".

Ky statut u shkrua, lexua dhe u firmos me vullnet të lirë e ndërgjegje të plotë nga aksionerët para noterizimit në Tiranë sot më datë 02.09.2002 në Tirane ne kater kopje në gjuhën shqipe.

AKSIONERET THEMELUES

- 1.Irfan HYSENBELLIU**
- 2.Alban XHAFERRI**
- 3.Lefter SOTA**

Irfan Hysenbelliu
Alban Xhafferi
Lefter Sota